



**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**JANAR - MARS
JANUAR - MART
2023**

I

**Buletini periodik i praktikës gjyqësore
të Gjykatës Kushtetuese**
(Janar– Mars 2023)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjyqimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjyqimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në bazë periodike dhe është përgatitur nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjyqimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

**Periodični bilten sudske
prakse Ustavnog suda**
(Januar-Mart 2023. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovani prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internetstranici Suda:

https://gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/

Napomena: Svako ko želi da kopira, preveđe ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

"Perandori Justinian", nr. 44. 10 000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 60 61 62
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576
Fax: +383(0) 38 60 61 70
Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org
©Gjykata Kushtetuese 2023

Tabela e përmbajtjes / Pregled sadržaja

I - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

I - Član 31 [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) Cenim i parimit të “qasjes në gjykatë”

(i) Povreda načela “pristupa sudu”

- Mos trajtimi nga gjykatat e rregullta i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me ligjshmërinë e Dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra e Ambasadorit, cenon parimin e “qasjes në drejtësi”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), duke pasur parasysh që Dekreti kishte karakter individual dhe prekte të “drejtat civile” të parashtruesit të kërkesës: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Nerazmatranje redovnih sudova navoda podnosioca zahteva u pogledu zakonitosti ukaza predsednika o njegovom razrešenju sa funkcije ambasadora, krši načelo „pristupa pravdi“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja zagaranovanog članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima (u daljem tekstu: EKLJP), s obzirom da je ukaz imao individualni karakter i da je uticao na „građanska prava“ podnosioca zahteva: povreda ustavnih prava.

KI214/21, Parashtrues: Avni Kastrati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës të Kosovës [ARJ.nr.84/2021], të 22 shtatorit 2021.....7

KI214/21, Podnosilac: Avni Kastrati, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Republike Kosova [ARJ.nr.84/2021] od 22. septembra 2021. godine.7

(ii) Cenim i të drejtës për një „vendim të arsyetuar”

(ii) Povreda prava na “obrazloženu odluku”

- Mos-adresimi i fakteve vendimtare dhe kushteve ligjore përkitazi me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis që i lejonin parashtruesit të kërkesës prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme përbën shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si dhe interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, të cilat kanë rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Nerešavanje odlučnih činjenica i zakonskih uslova u vezi sa omogućavanjem odlaganja izvršenja dve odluke relevantnog Ministarstva za životnu sredinu kojima je podnosiocu zahteva dozvoljena proizvodnja energije iz obnovljivih izvora predstavlja povredu prava na obrazloženu odluku, kao i pogrešno tumačenje i primenu zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva, u suprotnosti sa pravom na pravično suđenje zagaranovano članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: povreda ustavnih prava.

KI143/22, Parashtrues: Hidroenergji sh.p.k, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ.UZVP.nr. 51/2022] të 19 korrikut 2022.....10

KI143/22, Podnosilac: Hidroenergji d.o.o, Ocena ustavnosti presude [ARJ. UZVP. br. 51/2022] Vrhovnog suda Kosova od 19. jula 2022. godine.....10

(iii) Cenimi i të drejtës për një “vendim të arsyetuar”

(iii) Povreda prava na “obrazloženu odluku”

- Mos-adresimi i fakteve vendimtare dhe kushteve ligjore përkitazi me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis, që i lejonin parashtruesit të kërkesës prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, përbën shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si dhe interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, të cilat kanë rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: shkelje e të drejtave kushtetuese
- Nerešavanje odlučnih činjenica i zakonskih uslova u vezi sa omogućavanjem odlaganja izvršenja dve odluke relevantnog Ministarstva za životnu sredinu kojima je podnosiocu zahteva dozvoljena proizvodnja energije iz obnovljivih izvora predstavlja povredu prava na obrazloženu odluku, kao i pogrešno tumačenje i primenu zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva, u suprotnosti sa pravom na pravično suđenje zagaranovano članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: povreda ustavnih prava.

KI36/22, Parashtrues: “MATKOS GROUP“ sh.p.k, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. Nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021.....14

KI36/22, Podnosilac: “MATKOS GROUP“ d.o.o, Ocena ustavnosti presude [ARJ. br. 116/2021] Vrhovnog suda Kosova od 28. oktobra 2021. godine.....14

(iv) Cenimi i parimit të gjykimit “brenda një afati të arsyeshëm”

(iv) Povreda načela suđenja "u razumnom roku"

- Kohëzgjatja e procedurave lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës para gjykatave të rregullta për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite, përbën shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: shkelje e të drejtave kushtetuese
- Trajanje postupka u vezi sa tužbom podnosioca zahtevom pred redovnim sudovima više od 16 (šesnaest) godina predstavlja povredu prava na donošenje sudske odluke u razumnom roku, kao sastavni deo pravičnog suđenja zagaranovanog članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: povreda ustavnih prava.

KI06/21, Parashtrues: Dragan Mihajloviq, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën Ac. Nr. 3930/2016.....18

KI06/21, Podnosilac: Dragan Mihajloviq, Zahtev za ocenu ustavnosti postupaka pred Apelacionim sudom Republike Kosova u vezi sa predmetom Ac. br. 3930/2016.....18

(v) E drejta për seancë dëgjimore

(v) Pravo na saslušanje

- Mos mbajtja e seancës dëgjimore në dy nivele të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke pasur parasysh që gjykatat e rregullta nuk kanë trajtuar “çështjet ekskluzivisht ligjore ose të natyrës së lartë teknike” por edhe çështje faktike, përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: shkelje e të drejtave kushtetuese

- Neodržavanje ročišta na dva nivoa Posebne komore Vrhovnog suda, s obzirom da se redovni sudovi nisu bavili „isključivo pravnim ili visokotehničkim pitanjima“ već i činjeničnim pitanjima, predstavlja povredu prava na pravično suđenje zagantovano članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: povreda ustavnih prava.

KI108/22, Parashtrues: “Metalinvest S.H.A.”, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-19-0213] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 16 marsit 2022.....21

KI108/22, Podnosilac: “Metalinvest S.H.A.”, Ocena ustavnosti presude [AC-I-19-0213] Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju od 16. marta 2022. godine.....21

II - Neni 24 [Barazia para Ligjit]

II - Član 24 [Jednakost pred Zakonom]

(i) Barazia para ligjit

(i) Jednakost pred zakonom

- Dallimi në trajtim lidhur me përfitimin e pensionit kontributpagues, duke përcaktuar, në një rëndësi, se stazhi i punës për pension-kontributpagues për vitet 1989-1999, njihet për “punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”, ndërsa në anën tjetër, nuk i njihet kategorive të tjera të qytetarëve të cilët janë larguar nga puna gjatë viteve të ‘90-ta bazuar në ligje diskriminuese, përbën cenim të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së: shkelje e të drejtave kushtetuese
- Razlika u tretmanu u vezi sa sticanjem penzije platiša doprinosa, utvrđujući, s jedne strane, da se radni staž za penziju platiša doprinosa za godine 1989-1999 priznaje „za prosvetne, zdravstvene i druge radnike koji su radili u sistemu Republike Kosovo“, dok s druge strane, ne priznaje za druge kategorije građana koji su udaljeni sa posla tokom 90-ih godina na osnovu diskriminatornih zakona, predstavlja povredu prava na jednakost pred zakonom zagantovanog članom 24. Ustava i članom 14. EKLJP-a: povreda ustavnih prava.

KO190/19Parashtrues: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve.....25

KO190/19, PodnosilacVrhovni sud Republike Kosovo, Ocena ustavnosti člana 8. stava 2. Zakona br. 04/L-131 o penzijskim šemama finansiranim od države u vezi sa članovima 5. i 6. Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 09/2015 za kategorizaciju korisnika penzije platiša doprinosa prema kvalifikacionoj strukturi i dužini vremena uplate doprinosa.....25

III - Neni 25 [E Drejta për Jetën]

III - Član 25 [Pravo na Život]

(i) Cenimi i të drejtës për jetën

(i) Povreda prava na život

- Mosveprimi i autoriteteve përgjegjëse lidhur me rastin e dhunës në familje, që ka rezultuar në vdekjen e S.M., kishte cenuar të drejtën në jetë të S.M. të garantuar me nenin 25 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KEDNJ-së, pasi që autoritetet përgjegjëse kishin dështuar të bëjnë një vlerësim të mirëfilltë të rrezikut, i cili duhet të jetë autonom, proaktiv dhe i menjëhershëm, dhe marrë parasysh që autoritetet shtetërore ishin në dijeni apo ishin dashur të jenë në dijeni në lidhje me rrezikun e menjëhershëm dhe real për jetën e S.M.-së: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Neçinjenjem nadlezhnih organa u vezi sa slučajem nasilja u porodici, koje je za posledicu imalo smrt S.M., povređeno je pravo na život S.M. zagantovano članom 25. Ustava i članom 2. EKLJP-a, budući da nadležni organi nisu izvršili odgovarajuću procenu rizika, koja mora biti autonomna, proaktivna i neposredna, a uzimajući u obzir da su državni organi znali ili trebalo da znaju za neposrednu i stvarnu opasnost po život S.M.: povreda ustavnih prava

KI129/21, Parashtrues: Velerda Sopi, Vlerësim i kushtetushmërisë së “veprimeve dhe mosveprimeve” të Gjykatës Themelore në Gjiilan, Prokurorisë Themelore në Gjiilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë.....32

K129/21, Podnosilac zahteva: Velerda Sopi, Ocena ustavnosti “činjenja i nečinjenja” Osnovnog suda u Gnjilanu, Osnovnog tužilaštva u Gnjilanu, Policijske stanice u Gračanicu i Osnovnog tužilaštva u Prištini.....32

IV- Neni 46 [Mbrotjja e Pronës]

IV- Član 46 [Zastita imovine]

(i) E drejta e pronës dhe revokimi i licencës së punës

(i) Pravo na imovinu i opoziv radne dozvole

- Revokimi i licencës para skadimit të afatit përbën “ndërhyrje” në të drejtën në pronë të parashtruesit të kërkesës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, sepse parashtruesi i kërkesës kishte pritur legjitime që gjatë periudhës për të cilën kishte pasur licencën dhe leje të vlefshme të punës, bazuar në Ligjin paraprak për Lojërat e Fatit, ai do të mund të ushtronte aktivitetin e tij ekonomik dhe të gëzonte në mënyrë paqësore pronën e tij: shkelje e të drejtave kushtetuese.
- Opoziv licence pre isteka roka predstavlja „uplitanje“ u pravo na imovinu podnosioca zahteva, zagantovano članom 46. Ustava i članom 1. Protokola br. 1. EKLJP-a, jer je podnosilac zahteva imao legitimno očekivanje da bi tokom perioda za koji je imao važeću licencu i radnu dozvolu, na osnovu prethodnog Zakona o igrama na sreću, mogao da obavlja privrednu delatnost i mirno uživa svoju imovinu: povreda ustavnih prava

KI185/21, Parashtrues: SHPK „CO COLINA“, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.nr. 83/2021] të 7 shtatorit 2021.....39

K185/21, Podnosilac zahteva: „CO COLINA“ d.o.o., Zahtev za ocenu ustavnosti Zakona br. 06/L-155 o zabrani igara na sreću i presude [ARJ. UZVP. br. 83/2021] Vrhovnog suda od 7. septembra 2021. godine39

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenim i parimit të "qasjes në gjykatë"

KI214/21, Parashtrues: Avni Kastrati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ.nr.84/2021], të 22 shtatorit 2021.

Mos trajtimi nga gjykatat e rregullta i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me ligjshmërinë e Dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra e Ambasadorit, cenon parimin e "qasjes në drejtësi", si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh që Dekreti kishte karakter individual dhe prekte të "drejtat civile" të parashtruesit të kërkesës: *shkelje e të drejtave kushtetuese*.

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me lirimimin e parashtruesit të kërkesës nga detyra e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Sllovenisë nëpërmjet një dekreti të Presidentes së Republikës së Kosovës. Kundër Dekretit të Presidentes, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kjo e fundit e kishte hedhur poshtë padinë si të palejuar, ndër tjerash, me arsyetimin se sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, një dekret i Presidentes nuk mund të jetë objekt vlerësimi në procedurën e konfliktit administrativ, por i njëjti mund t'i nënshtrohet vetëm procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i Gjykatës Themelore ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.

Çlan 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda načela "pristupa sudu"

KI214/21, Podnosilac: Avni Kastrati, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Republike Kosova [ARJ.nr.84/2021] od 22. septembra 2021. godine

Nerazmatranje redovnih sudova navoda podnosioca zahteva u pogledu zakonitosti ukaza predsednika o njegovom razrešenju sa funkcije ambasadora, krši načelo „pristupa pravdi“, kao sastavnog dela pravičnog suđenja zagaranovanog članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima (u daljem tekstu: EKLJP), s obzirom da je ukaz imao individualni karakter i da je uticao na „građanska prava“ podnosioca zahteva: *povreda ustavnih prava*

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja se odnose na razrešenje podnosioca zahteva sa mesta ambasadora Republike Kosovo u Republici Sloveniji putem ukaza predsednice Republike Kosovo. Protiv ukaza predsednice, podnosilac zahteva je podneo tužbu Osnovnom sudu u Prištini. Poslednje navedeni je odbio tužbu, kao nedozvoljenu, između ostalog, sa obrazloženjem da prema odredbama Zakona o upravnim sporovima, ukaz predsednika ne može biti predmet ocene u upravnom postupku, već isti može biti predmet samo postupka ocene ustavnosti od strane Ustavnog suda. Odluku Osnovnog suda su potvrdili Apelacioni sud i Vrhovni sud.

Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva je pred Ustavnim sudom navodio da su mu redovni sudovi, time što nisu ocenili zakonitost osporenog ukaza, povredili osnovna prava i slobode zagaranovane članovima: 7. [Vrednosti], 65. [Nadležnosti Skupštine], 84. [Nadležnosti predsednika], 24. [Jednakost pred zakonom], 31. [Pravo na

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese pretendoi se, duke mos vlerësuar ligjshmërinë e dekretit të kontestuar, gjykatat e rregullta kishin shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 84 [Kompetencat e Presidentit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës. Kjo sepse, mes tjerash, parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar e drejta për të përdorur mjetet juridike efektive në gjykatat e rregullta për të mbrojtur të drejtat e tij subjektive.

Gjetjet e Gjykatës

Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht vlerësoi se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhej me të drejtën për “*qasje në drejtësi*”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht shtjelloi (i) parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me parimin e “*qasjes në drejtësi*”; (ii) juridiksionin e gjyqësorit të rregullt dhe të saj, në trajtimin e akteve konkrete individuale në kuptim të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, me ç’rast, ndër tjerash, theksoi se ekziston një pozicion i qartë sa i përket funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues, duke rikujtuar se i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht të përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjin, ndërsa i dyti, përkatësisht Gjykata Kushtetuese, kujdeset për ruajtjen e

pravično i nepristrasno suđenje], 32. [Pravo na pravno sredstvo], 45. [Pravo na izbor i učešće], 54. [Sudska zaštita prava] i 55. [Ograničenje prava i osnovnih sloboda] Ustava. Ovo iz razloga što je, između ostalog, podnosiocu zahteva uskraćeno pravo da koristi delotvorna pravna sredstva u redovnim sudovima za zaštitu svojih subjektivnih prava.

Nalazi Suda

Osvrćući se na navode podnosioca zahteva, Sud je prvo ocenio da se suština navoda podnosioca zahteva odnosi na pravo na „pristup pravdi“, kao sastavni deo pravičnog i nepristrasnog suđenja zagaranovanog članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima. U tom kontekstu, Sud je prvo razradio (i) opšta načela svoje sudske prakse i Evropskog suda za ljudska prava u vezi sa načelom „pristupa pravdi“; (ii) nadležnost redovnog sudstva i svoju nadležnost u razmatranju konkretnih individualnih akata u smislu člana 113. [Jurisdikcija i ovlašćene strane] Ustava, gde je, između ostalog, naglasio da postoji jasan stav koji se odnosi na funkcije redovnog i ustavnog sudstva, podsećajući da prvo vodi računa o očuvanju pravne supremacije zakona, odnosno usklađenosti podzakonskih akata sa zakonom, dok drugo, odnosno Ustavni sud, preuzima staranje o očuvanju pravne supremacije Ustava kroz proveru ustavnosti zakona i drugih akata sa Ustavom; i (iii) prirodu/karakter pravnih akata, sa posebnim naglaskom na ukaze predsednika sa individualnim karakterom kroz koje se može uticati na prava i slobode određenih pojedinaca, okolnosti u kojima, na osnovu Ustava Republike Kosovo, važećeg zakonodavstva, ali i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava i većine država članica Foruma Venecijanske komisije, pogođene strane imaju pravo da koriste pravna sredstva u redovnim sudovima, osim kada je

supremacisë juridike të Kushtetutës nëpërmjet kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera me Kushtetutën; dhe (iii) natyrën/karakterin e akteve juridike, me theks të posaçëm të dekreteve presidenciale me karakter individual përmes të cilëve mund të afektohen të drejtat dhe liritë e individëve të caktuar, rrethana këto në të cilat, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin e aplikueshëm por edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe atë të shumicës së shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, palët e afektuara kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në gjykatat e rregullta, përveç kur një mundësi e tillë kufizohet specifikisht me ligj dhe një kufizim i tillë është i justifikueshëm.

Gjykata, duke aplikuar këto parime në rrethanat e rastit konkret, konstatoi se dekreti i kontestuar i Presidentes për lirim nga pozita të parashtruesit të kërkesës, ngërthente të “drejta civile” të parashtruesit të kërkesës dhe “kontest” apo “mosmarrëveshje” në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për pasojë, dhe edhe duke u bazuar në dispozitat kushtetuese dhe legjislacionin e aplikueshëm, i takon grupit të dekreteve të karakterit individual të cilat mund të kontestohen në gjykatat e rregullta. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se hedhja poshtë e padisë së parashtruesit të kërkesës si e palejuar, i kishte pamundësuar atij të drejtën për “qasje në drejtësi” në cenim të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfundimi

Për pasojë dhe bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konkludoi se, Aktgjykimi [ARJ.nr.84/2021] i Gjykatës Supreme, i 22 shtatorit 2021, Aktvendimi

takva mogućnost izričito ograničena zakonom i takvo ograničenje obrazloženo.

Sud je, primenjujući ova načela u okolnostima konkretnog slučaja, utvrdio da je osporenim ukazom predsednice o razrešenju podnosioca zahteva sa položaja došlo do uplitanja u „građanska prava“ podnosioca zahteva i „spor“ ili „neslaganje“ u smislu prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovanog članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, a samim tim, i na osnovu ustavnih odredbi i važećeg zakonodavstva, spada u grupu ukaza individualnog karaktera koji se mogu osporiti pred redovnim sudovima. Shodno tome, Sud je utvrdio da mu je odbijanje tužbe podnosioca zahteva, kao nedozvoljene, uskratilo pravo na „pristup pravdi“ kršeći prava zagarantovana članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima.

Zaključak

Shodno tome i na osnovu pojašnjenja datih u objavljenoj presudi, Sud je zaključio da presuda [ARJ. br. 84/2021] od 22. septembra 2021. godine Vrhovnog suda, presuda [AA. br. 612/2021] od 13. jula 2021. godine Apelacionog suda i rešenje [A. br. 1297/2021] od 1. juna 2021. godine Osnovnog suda u Prištini, nije u skladu sa članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

[AA.nr.612/2021] i Gjykatës së Apelit, i 13 korrikut 2021, dhe Aktvendimi [A.nr.1297/2021] i Gjykatës Themelore në Prishtinë i 1 qershorit 2021, nuk janë në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenim i të drejtës për një “vendim të arsyetuar”

KI143/22,Parashtrues: “Hidroenergji” Sh.P.K, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ.UZVP.nr. 51/2022] të 19 korrik-ut 2022

Mos-adresimi i fakteve vendimtare dhe kushteve ligjore përkitazi me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis që i lejonin parashtruesit të kërkesës prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme përbënë shkelje të së drejtë për një vendim të arsyetuar,si dhe interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, të cilat kanë rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: - shkelje e të drejtave kushtetuese

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me vendimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, për lëshimin e lejes ujore dhe lejes mjedisore respektivisht, bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Ligjin nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat i kanë mundësuar parashtruesit të kërkesës

Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda prava na „obrazloženu odluku”

KI143/22, Podnosilac: Hidroenergji d.o.o, Ocena ustavnosti presude [ARJ. UZVP. br. 51/2022] Vrhovnog suda Kosova od 19. jula 2022. godine

Nerešavanje odlučnih činjenica i zakonskih uslova u vezi sa omogućavanjem odlaganja izvršenja dve odluke relevantnog Ministarstva za životnu sredinu kojima je podnosiocu zahteva dozvoljena proizvodnja energije iz obnovljivih izvora predstavlja povredu prava na obrazloženu odluku, kao i pogrešno tumačenje i primenu zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva, u suprotnosti sa pravom na pravično suđenje zagarantovano članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: povreda ustavnih prava

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja povezane su sa odlukama Ministarstva infrastrukture i životne sredine i Ministarstva ekonomije i životne sredine o izdavanju vodne i ekološke dozvole, respektivno, na osnovu Zakona br. 04/L-147 o vodama Kosova i Zakona br. 03/L-025 o zaštiti životne sredine, koje su podnosiocu zahteva omogućile ulaganje kroz izgradnju

investimin nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës për hidrocentrale me qëllim të ushtrimit të aktivitetit të tij biznesor për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Dy organizata jo-qeveritare kontestuan ligjshmërinë e këtyre dy vendimeve nëpërmjet padive të parashtruara në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke propozuar, ndër tjerash, shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore.

Gjykata Themelore e kishte aprovuar si të bazuar propozimin e dy organizatave jo-qeveritare dhe kishte marrë vendimin që të shtyhet ekzekutimi i vendimeve të Ministrisë përgjegjëse për Mjedis, përkatësisht lejes ujore dhe asaj mjedisore, derisa Gjykata Themelore të vendos me vendim përfundimtar përkitazi me meritat e çështjes. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e palës së interesuar, Gjykata e Apelit vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, ndërsa, kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, kjo e fundit këtë kërkesë e refuzoi si të pabazuar duke vërtetuar konstatimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe interpretimit të gabuar të ligjit, në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e

infrastrukture za hidroelektrane, za potrebe obavljanja njegove poslovne delatnosti proizvodnje energije iz obnovljivih izvora. Dve nevladine organizacije su osporile zakonitost ovih odluka tužbama podnetim Osnovnom sudu u Prištini, predloživši, između ostalog, da se odloži izvršenje odluka Ministarstva do meritornog rešavanja predmeta. Osnovni sud je usvojio, kao osnovan, predlog dve nevladine organizacije i doneo odluku da se odloži izvršenje odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu, odnosno vodne i ekološke dozvole dok Osnovni sud ne odluči konačnom odlukom o meritumu predmeta. Nakon žalbe koju je uložio podnosilac zahteva u svojstvu zainteresovane strane, Apelacioni sud je potvrdio rešenje Osnovnog suda, dok je zahtev za vanredno preispitivanje sudske odluke koji je podnosilac zahteva podneo Vrhovnom sudu, taj sud odbio kao neosnovan i potvrdio nalaze Osnovnog suda i Apelacionog suda.

Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva je pred Sudom naveo da su mu povređena osnovna prava i slobode zagarantovane članovima 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] i 46. [Zaštita imovine] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) i članom 1. Protokola br. 1 (Zaštita imovine) Evropske konvencije o ljudskim pravima, kao rezultat nedostatka obrazložene sudske odluke i pogrešnog tumačenja zakona, u suprotnosti sa procesnim garancijama utvrđenim članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, sa naglaskom na postupak koji je sproveden pred Vrhovnim sudom.

Nalazi Suda

Prilikom ocene navoda podnosioca zahteva, Sud je prvo razradio opšta načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava u vezi sa obrazloženjem sudskih

Njeriut, me theks në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme.

Gjetjet e Gjykatës

Në vlerësimin e pretendimeve të parashtresit të kërkesës, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe interpretimin qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit, dhe më pas aplikoi të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Në këtë aspekt, Gjykata konstatoi që, Gjykata Supreme, përtej përshkrimit të dispozitave ligjore, nuk kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm përkitazi me kriteret që duhet të plotësohen për të vendosur për pezullimin e vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis. Për më tepër, dhe përkundër faktit që mungesa e trajtimit të këtyre dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative ishte ngritur në mënyrë të vazhdueshme nëpër instanca gjyqësore përmes ankesave përkatëse nga parashtresi i kërkesës, Gjykata Supreme kishte miratuar qëndrimin e Gjykatës Themelore dhe atë të Gjykatës së Apelit, duke mos adresuar argumentet thelbësore të tij.

Në këtë kuptim, Gjykata në rastin KI202/21, me parashtres *Kelkos Energy SH.P.K.*, kishte theksuar rëndësinë që vendosja e masave të përkohshme, përkatësisht pezullimi i ekzekutimit të vendimeve, deri në zgjidhjen meritorë të çështjeve duhet të jetë i arsyeshëm, proporcional dhe i bazuar në arsyetim të detajuar të plotësimin të kriterëve të përcaktuara në këtë kontekst në dispozitat respektive të Ligjit për Konfliktet Administrative. Më konkretisht, Gjykata duke dhënë një vlerësim të tërësishëm të rrethanave të rastit konkret, konstatoi se, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, nuk ka adresuar plotësisht dhe në

odluka i očigledno pogrešnim i proizvoljnim tumačenjem zakona, a zatim je primenio ista načela na okolnosti konkretnog slučaja. U tom smislu, Sud je utvrdio da Vrhovni sud, osim opisa zakonskih odredbi, nije izneo dovoljno obrazloženje u pogledu kriterijuma koji moraju biti ispunjeni da bi se odlučilo o suspenziji odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu. Pored toga, i uprkos činjenici da je izostanak ispitivanja ovih odredbi Zakona o upravnim sporovima kontinuirano istican pred sudskim instancama kroz relevantne žalbe od strane podnosioca zahteva, Vrhovni sud uvažio stav Osnovnog i Apelacionog suda, ne ispitujući njegove suštinske argumente.

U tom smislu, Sud je u slučaju KI202/21, sa podnosiocem „*Kelkos Energy*“ d.o.o., istakao važnost da uvođenje privremenih mera, odnosno obustava izvršenja odluka do meritornog rešavanja predmeta, mora biti razumno, srazmerno i zasnovano na detaljnom obrazloženju o ispunjenosti kriterijuma utvrđenih u ovom kontekstu u relevantnim odredbama Zakona o upravnim sporovima. Konkretnije, Sud je, pružajući sveobuhvatnu ocenu okolnosti konkretnog slučaja, utvrdio da osporenom presudom Vrhovnog suda u vezi sa rešenjima Osnovnog i Apelacionog suda, nisu potpuno i jasno ispitane odlučne činjenice i zakonski uslovi utvrđeni članom 22. Zakona o upravnim sporovima, koji se odnose na dozvoljavanje odlaganja izvršenja dvaju odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu, a kao rezultat toga, ista su zahvaćena pogrešnim tumačenjem i primenom zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva.

Sud je naglasio da je njegova presuda doneta samo u odnosu na postupak za suspenziju osporenih odluka o izdavanju vodne i ekološke dozvole od strane Ministarstva nadležnog za životnu sredinu pred redovnim sudovima, dok ti sudovi ne odluče o meritumu tužbe. Pitanje

mënyrë të qartë faktet vendimtare dhe kushtet ligjore të përcaktuar me nenin 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, përkritazi me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis, dhe si rrjedhojë të njëjtat janë përfshirë me interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, të cilat kanë rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës.

Gjykata theksoi se, Aktgjykimi i saj është nxjerrë vetëm përkritazi me procedurën për pezullimin e vendimeve të kontestuara për lëshimin e lejes ujore dhe asaj mjedisore nga Ministria përkatëse për Mjedis para gjykatave të rregullta, deri sa këto të fundit të vendosin lidhur me meritat e padisë. Çështja e ligjshmërisë së vendimeve të kontestuara të Ministrisë përkatëse për Mjedis është në shqyrtim para gjykatave të rregullta dhe Aktgjykimi i Gjykatës në këtë rast në asnjë mënyrë nuk paragjykon vendimmarrjen e tyre përkritazi me padinë ndaj vendimeve të kontestuara të kësaj ministrie.

Përfundimi

Përfundimisht, bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktgjykimi [ARJ. UZVP. nr. 51/2022] i 19 korrikut 2022 i Gjykatës Supreme, Aktvendimi [AA. nr. 386/2022] i 26 majit 2022 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [A. nr. 3129/2021] i 12 prillit 2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe interpretimit dhe zbatimit arbitrar të ligjit, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Themelore.

zakonitosti osporenih odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu nalazi se na razmatranju pred redovnim sudovima, a presuda Suda u ovom slučaju ni na koji način ne prejudicira njihovo odlučivanje po tužbi protiv osporenih odluka tog ministarstva.

Zaključak

Konačno, a na osnovu pojašnjenja navedenih u objavljenoj presudi, Sud je utvrdio da su presuda [ARJ. UZVP. br. 51/2022] Vrhovnog suda od 19. jula 2022. godine, rešenje [AA. br. 386/2022] Apelacionog suda od 26. maja 2022. godine i rešenje [A. br. 3129/2021] Osnovnog suda u Prištini od 12. aprila 2022. godine, doneti u suprotnosti sa procesnim garancijama utvrđenim članom 31. Ustava u vezi sa članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, zbog nepostojanja obrazložene sudske odluke i proizvoljnog tumačenja i primene zakona, te vratio predmet Osnovnom sudu na ponovno razmatranje.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

Cenimi i të drejtës për një “vendim të arsyetuar”

KI36/22, Parashtrues: “MATKOS GROUP” sh.p.k, Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. Nr. 116/2021] të 28 tetorit 2021

Mos-adresimi i fakteve vendimtare dhe kushteve ligjore përkitazi me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë përkatëse për Mjedis që i lejonin parashtruesit të kërkesës prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme përbën shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si dhe interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, të cilat kanë rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së: *shkelje e të drejtave kushtetuese*

Faktet

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me vendimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit përkitazi me dhënien e lejeve ujore dhe mjedisore, bazuar në Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilat i kishin mundësuar parashtruesit të kërkesës të investojë në ndërtimin e infrastrukturës për hidrocentrale, me qëllim të kryerjes së veprimtarisë së tij afariste të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Dy organizata joqeveritare e kontestuan ligjshmërinë e këtyre vendimeve përmes padive në Gjykatën Themelore, ku ndër të tjera, propozuan shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë deri në zgjidhjen e meritave të rastit.

Çlan 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

Povreda prava na “obrazloženu odluku”

KI36/22, Podnosilac: “MATKOS GROUP“ d.o.o, Ocena ustavnosti presude [ARJ. br. 116/2021] Vrhovnog suda Kosova od 28. oktobra 2021. godine

Nerešavanje odlučnih činjenica i zakonskih uslova u vezi sa omogućavanjem odlaganja izvršenja dve odluke relevantnog Ministarstva za životnu sredinu kojima je podnosiocu zahteva dozvoljena proizvodnja energije iz obnovljivih izvora predstavlja povredu prava na obrazloženu odluku, kao i pogrešno tumačenje i primenu zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva, u suprotnosti sa pravom na pravično suđenje zagarantovano članom 31. Ustava i članom 6. EKLJP-a: *povreda ustavnih prava*

Činjenice

Okolnosti konkretnog slučaja su povezane sa odlukama Ministarstva infrastrukture i životne sredine i Ministarstva ekonomije i životne sredine u vezi sa izdavanjem vodne i ekološke dozvole, respektivno, na osnovu Zakona br. 04/L-147 o vodama Kosova i Zakona br. 03/L-025 o zaštiti životne sredine, koje su podnosiocu zahteva omogućile ulaganje kroz izgradnju infrastrukture za hidroelektrane, za potrebe obavljanja njegove poslovne delatnosti proizvodnje energije iz obnovljivih izvora. Dve nevladine organizacije su osporile zakonitost ovih odluka tužbama podnetim Osnovnom sudu, predloživši, između ostalog, da se odloži izvršenje odluka Ministarstva do meritornog rešavanja predmeta.

Osnovni sud je usvojio, kao osnovan, predlog dve nevladine organizacije i doneo odluku da se odloži izvršenje odluka Ministarstva

Gjykata Themelore e kishte aprovuar si të bazuar propozimin e dy organizatave joqeveritare dhe nxori vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Ministrisë kompetente për mjedisin, përkatësisht lejes ujore dhe mjedisore, derisa Gjykata Themelore të marrë vendim përfundimtar për meritat e rastit. Pas ankesës së bërë nga parashtruesi i kërkesës, në cilësi të palës së interesuar, Gjykata e Apelit e anuloi aktvendimin e shkallës së parë dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Themelore për rivendosje. Pas procedurës së përsëritur, Gjykata Themelore sërish e aprovoi si të bazuar propozimin e paditësve dhe shtyu ekzekutimin e vendimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, përkatësisht të vendimit për miratimin e lejes ujore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata përkitazi me padinë e paditësve. Pas kësaj, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e shkallës së parë në atë mënyrë që refuzoi propozimin e organizatave joqeveritare për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për miratimin e lejes ujore, deri në vendimin përfundimtar lidhur me padinë e paditësve. Duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të organizatave joqeveritare, Gjykata Supreme miratoi kërkesën e tyre, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore.

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendoi se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

nadležnog za životnu sredinu, odnosno vodne i ekološke dozvole dok Osnovni sud ne odluči konačnom odlukom o meritumu predmeta. Nakon žalbe koju je uložio podnosilac zahteva u svojstvu zainteresovane strane, Apelacioni sud je poništio prvostepeno rešenje i predmet vratio Osnovnom sudu na ponovno odlučivanje. Osnovni sud je nakon toga u ponovljenom postupku, ponovo usvojio, kao osnovan, predlog tužilaca i odložio izvršenje odluke MEŽS-a, odnosno odluke o odobrenju vodne dozvole, dok sud konačnom odlukom ne odluči po tužbi tužilaca. Nakon toga je odlučujući po žalbi podnosioca zahteva Apelacioni sud preinačio prvostepenu odluku na način da je odbio predlog nevladinih organizacija za odlaganje izvršenja odluke MEŽS-a o odobrenju vodne dozvole do konačne sudske odluke po tužbi tužilaca. Odlučujući po zahtevu za vanredno preispitivanje sudske odluke nevladinih organizacija, Vrhovni sud je usvojio njihov zahtev, na način da je poništio presudu Apelacionog suda i ostavio na snazi prvostepenu presudu Osnovnog suda.

Žalba podnosioca zahteva

Podnosilac zahteva je pred Sudom naveo da su mu povređena osnovna prava i slobode zagarantovane članovima 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] i 46. [Zaštita imovine] Ustava u vezi sa članom 6. (Pravo na pravično suđenje) i članom 1. Protokola br. 1 (Zaštita imovine) Evropske konvencije o ljudskim pravima, kao rezultat nedostatka obrazložene sudske odluke i pogrešnog tumačenja zakona, u suprotnosti sa procesnim garancijama utvrđenim članom 31. Ustava i članom 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima, sa naglaskom na postupak koji je sproveden pred Vrhovnim sudom.

Nalazi Suda

si pasojë e mungesës të një vendimi gjyqësor të arsyetuar dhe interpretimit të gabuar të ligjit, në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me theks të veçantë në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Supreme.

Gjetjet e Gjykatës

Gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari (i) shtjelloi parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe interpretimin qartazi të gabuar dhe arbitrar të ligjit, dhe më pas (ii) zbatoi të njëjtat parime në rrethanat e rastit konkret. Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se, Gjykata Supreme, përveç përshkrimit të dispozitave ligjore, nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me kriteret që duhet të plotësohen për të vendosur për pezullimin e vendimeve të Ministrisë kompetente për Mjedisin. Përveç kësaj, dhe përkundër faktit se mungesa e shqyrtimit të këtyre dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative është theksuar në vazhdimësi në instancat gjyqësore përmes ankesave përkatëse nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme pranoi qëndrimin e Gjykatës Themelore, duke mos i shqyrtuar argumentet thelbësore të parashtruesit përkatës.

Gjykata, duke bërë një vlerësim gjithëpërfshirës të rrethanave të rastit konkret konstatoi se, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në lidhje me aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, nuk i ka shqyrtuar plotësisht dhe qartë faktet vendimtare dhe kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat i referohen lejimit të shtyrjes së ekzekutimit të dy vendimeve të Ministrisë kompetente për mjedisin, dhe si rrjedhojë të njëjtat janë përfshirë me

Prilikom ocene navoda podnosioca zahteva, Sud je prvo (i) razradio opšta načela svoje sudske prakse i sudske prakse Evropskog suda za ljudska prava u vezi sa obrazloženjem sudskih odluka i očigledno pogrešnim i proizvoljnim tumačenjem zakona, a zatim je (ii) primenio ista načela na okolnosti konkretnog slučaja. U tom smislu, Sud je utvrdio da Vrhovni sud, osim opisa zakonskih odredbi, nije izneo dovoljno obrazloženje u pogledu kriterijuma koji moraju biti ispunjeni da bi se odlučilo o suspenziji odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu. Pored toga, i uprkos činjenici da je izostanak ispitivanja ovih odredbi Zakona o upravnim sporovima kontinuirano istican pred sudskim instancama kroz relevantne žalbe od strane podnosioca zahteva, Vrhovni sud uvažio stav Osnovnog suda, ne ispitujući suštinske argumente relevantnog podnosioca zahteva.

Sud je, pružajući sveobuhvatnu ocenu okolnosti konkretnog slučaja, utvrdio da osporenom presudom Vrhovnog suda u vezi sa rešenjima Osnovnog i Apelacionog suda, nisu potpuno i jasno ispitane odlučne činjenice i zakonski uslov i utvrđeni članom 22. Zakona o upravnim sporovima, koji se odnose na dozvoljavanje odlaganja izvršenja dvaju odluka Ministarstva nadležnog za životnu sredinu, a kao rezultat toga, ista su zahvaćena pogrešnim tumačenjem i primenom zakona, što je rezultiralo proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva. Sud je takođe naglasio da je njegova sudska praksa u ovom kontekstu već veoma konsolidovana i da je zadržao isti stav u tri prethodne presude, odnosno u slučajevima KI75/21, podnosilac zahteva: „*Ahrazen LLC*“, „*Energy Development Group – Kosova LLC*“, „*Alsi & Co. Kosove LLC*“ i „*Building Construction LLC*“, presuda od 19. januara 2022. godine; KI202/21, podnosilac zahteva: „*Kelkos Energy*“ D.O.O., presuda od 29. septembra 2022. godine, i KI143/22,

interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, që rezultoi në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës. Gjykata gjithashtu theksoi që, tashmë praktika e saj gjyqësore në këtë kontekst është tejte e konsoliduar dhe ka mbajtur qëndrim të njëjtë edhe në tri Aktgjykime paraprake, përkatësisht në rastet KI75/21, parashtrues: “*Abrazen LLC*”, “*Energy Development Group Kosova LLC*”, “*Alsi & Co. Kosovë LLC*” dhe “*Building Construction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022; KI202/21, parashtrues: “*Kelkos Energy*” sh.p.k, Aktgjykim i 29 shtatorit 2022; dhe KI143/22, parashtrues: *Hidroenergji sh.p.k.*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, duke theksuar, ndër tjerash, që vendosja e masave të përkohshme, përkatësisht pezullimi i ekzekutimit të vendimeve deri në zgjidhjen meritore të rastit, duhet të jetë i arsyeshëm, proporcional dhe i bazuar në një arsyetim të detajuar të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në këtë kontekst, në dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative.

